



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (5) (anglisht)

Ngarkesa: 4 kredite 40 seminare
Viti / Semestri : Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore : Të zhvillojë kompetencat gjuhësore bazë të studentëve në anglisht: të folurit, dëgjimin, të shkruarit dhe leximin. Të përmirësojë aftësinë e komunikimit të qartë dhe rrjedhshëm në gjuhën angleze në situata të përditshme dhe akademike. Të nxisë pavarësinë në të nxënë dhe pasurimin e fjalorit përmes aktiviteteve ndëraktive dhe teksteve autentike.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të forcojë aftësitë për të lexuar dhe analizuar tekste të ndryshme (letra, reklama, artikuj, pjesë letrare, broshura etj.).
2. Të zhvillojë aftësitë e të shkruarit për forma të ndryshme (letër aplikimi, raport, artikull, histori e shkurtër, përshkrim etj.).
3. Të përmirësojë dëgjimin dhe të folurin në kontekste reale: lajme, biseda, drama, reklama, etj., si dhe të stimulojë përvetësimin e fjalorit dhe vetëkorrigjimin.

Rezultatet e pritshme: Në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Lexojnë dhe kuptojnë tekste të ndryshme, duke identifikuar idetë kryesore, strukturën dhe informacionin specifik.
2. Komunikojnë në mënyrë të qartë dhe të saktë me folës vendas në situata të jetës së përditshme dhe në diskutime.
3. Shkruajnë tekste të ndryshme me organizim logjik, drejtshkrim të saktë dhe përdorim të duhur të gramatikës e pikësimit, si dhe të shprehin me gojë e me shkrim opinionet dhe argumentet për tema të caktuara.